

NJOFTIM
Nr. 3582/1, datë 29.9.2022

**PËR SHPALLJEN E NJË VENDI VAKANT PËR POZICIONIN E SPECIALISTIT
TË FINANCË-BUXHETIT NË KOMISIONIN E PAVARUR TË KUALIFIKIMIT, ME
AFAT 6 DERI NË 12 MUAJ**

Në zbatim të nenit 20, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shpall fillimin e procedurave për personat e interesuar, që kërkojnë të aplikojnë për pozicionin vakante të Specialistit të Financë-Buxhetit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, kategoria e pagës: III-b.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

- a) të zotërojë diplomë të nivelit master shkencor në Ekonomi, dega Financë;
- b) të ketë njohuri shumë të mira të gjuhës angleze;
- c) të ketë të paktën 2 vjet përvojë pune në profesion;
- d) të ketë njohuri në programet financiare, si: Alpha/Financa 5 etj.

Kushte të përgjithshme:

- Kandidati duhet të plotësojnë kriteret për t’u pajisur me certifikatë sigurie, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 188, datë 4.3.2015;
- Ndaj tij të mos jetë nisur procedim penal, të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi ose kundërvajtjeje penale;
- Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore me largim nga detyra ose ndonjë masë tjetër disiplinore, e cila është ende në fuqi, sipas legjislacionit, në momentin e aplikimit;
- Kandidati duhet të kenë aftësi për t’u përshtatur e për të punuar në grup, nën presion, si dhe në afate kohore të limituara.

Kandidati i interesuar duhet të dorëzojë dokumentet e mëposhtme:

1. Kërkesë me shkrim, shprehje interesi;
2. Jetëshkrim profesional, përfshirë të dhënat e kontaktit, postën elektronike zyrtare dhe adresën postare;
3. Kopje të dokumenteve (diplomë, letërnjoftim, librezë pune) (origjinale ose të noterizuara);
4. Dëshmi penaliteti;
5. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
6. Çdo dokumentacion tjetër, që vërteton plotësimin e kushteve të mësipërme, si dhe në trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrim.

Aplikimet duhet të dorëzohen brenda datës 12 tetor 2022, pranë institucionit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në adresën: Rruga e Kavajës, ish-Lidhja e Shkrimtarëve, Tiranë, Zyra e Protokollit, nga e hëna–të premte, ora 08:30–17:00, ose nëpërmjet postës elektronike, në adresën: info@kpk.al, i cili konfirmon nëpërmjet postës elektronike marrjen e aplikimit përkatës.